



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:221648

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05443219

P.nr.128/2023

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari i vetëm Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. S. R. nga ....., për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8, lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare av. Ardit Latifi nga Gjilani, sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.1536/2023 të datës 20.11.2023, më datë 28.02.2024, me rastin e mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prani të palëve, shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 13.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I a k u z u a r i :**

**Sh. R.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati S. dhe e ëma Q., e lindur S., i lindur më datë ..... në ..... me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i katër fëmijëve, penzioner, i gjendjes së mesme ekonomike, sipas të dhënave që disponon gjykata i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë për veprë tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

**Ë s h t ë f a j t o r**

**S e p s e:**

Më datën 26.09.2023, rreth orës 09:40 minuta, në rrugën ....., më saktësisht në fshatin, i pandehuri Sh. R., nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik duke e vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që

duke e drejtuar automjetin e tij për pasagjer të markës “Nisan Double” me targa të regjistrimit ....., ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore, neni 53 parag.1 i Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit rrugor të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që duke mos e përshtatur shpejtësinë e automjetit të tij, kushteve të rrugës, me të arritur afër fabrikës së ..., merr kthesë në të majtë humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe del jashtë rrugës në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes dhe përfundon i rrokullisur, dhe nga ky aksident i komunikacionit, përpos dëmeve materiale të shkaktuara në automjet, lëndime të rënda trupore pësojnë pasagjerët – bashkëshortja e tij Xh. R., , ndërsa Sh. S. pëson lëndime të lehta trupore të konstatuara nga ekspertiza mjeko- ligjore , me nr. ref.-07/23 e datës 20.10.2023.

- me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

Andaj, gjykata duke vepruar konform neneve 4, 7, 17, paragrafi 1, 23, 73 dhe 74, paragrafi 1, pika 1.1 të KPRK-së, të akuzuarin Sh. R., e

### **L i r o n   n g a   d ë n i m i**

Për shkak se pasojat e veprës penale aq shumë e godasin kryesin e veprës penale sa që dënimi është i panevojshëm me qëllim të arritjes së efektit të dënimit.

Të dëmtuarit Xh. R. dhe Sh.S., nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk parashtrojnë kërkesë pasure juridike.

Refuzohet propozimi i Prokurorisë së Shtetit që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtoj shumën prej 20 €, si dhe 20 € në emër të shpenzimeve të ekspertizës mjeko ligjore, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1536/2023 të datës 20.11.2023, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit Sh.S. R. nga ....., të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës, konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për datë 28.02.2024, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari Sh.R. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit thekson se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, njëherit thekson se janë plotësuar kushtet për pranimin e fajësisë nga i akuzuari përkitazi për veprën penale me të cilat akuzohet sipas aktit akuzues.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari edhe atë pas konsultimit me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari Shaip Robelli, nga pakujdesia ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokuroja e shtetit Rozelida Manastiri, në fjalën përfundimtare deklaroi se gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari Sh. R., e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë,

pranimin e fajësisë i njëjti e bëri vullnetarisht pa ndikim të dhunës, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban. Andaj kërkon nga gjykata që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të njëjtin ta dënojë me dënim të paraparë me ligj, duke i marr parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale. Si rrethana lehtësuese i propozon gjykatës që të ketë parasysh, moshën e të pandehurit, kryerjen e veprës penale nga pakujdesia, sjelljen korrekte para kësaj gjykate si dhe faktin që i njëjti për herë të parë bie ndesh me ligjin. Ndërsa si rrethana rënduese të ketë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale si dhe natyrën e lëndimeve të pësuar tani e dëmtuara Xh. R.. Gjithashtu propozon që konform nenit 59 par.1 dhe 2, nën par.2.5 të KPRK-së, të akuzuarit t'i shqiptojë dënimin plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit.

E dëmtuara në cilësi të dëshmitares Xh. R. (bashkëshortja e të akuzuarit), në fjalën përfundimtare deklaroi se, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, për faktin se me rastin e aksidentit bashkëshorti i saj, tani i akuzuari Sh. ka qenë shumë i shqetësuar dhe shumë rëndë e ka përjetuar rastin që i ka ndodhur, për shkak të lëndimeve të ka pësuar ajo, po ashtu i njëjti pas aksidenti personalisht është kujdesur për shëndetin e saj.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit Sh. S. (daja i të akuzuarit), në fjalën përfundimtare deklaroi se, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. R., av.Ardit Latifi, në fjalën përfundimtare deklaroi se, duke marrë parasysh se, i akuzuari Sh. R. ka pranuar fajësinë qysh gjatë dhënies së deklaratës në prokurori atëherë vlerëson se gjykata në raport me llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të njëjtit të ketë parasysh pranimin e fajësisë, karakteristikat personale të të njëjtit, i cili asnjëherë deri me tani nuk ka rënë ndesh me ligjin, është njeri familjar. Po ashtu mbrojtja i rekomandon gjykatës që në rastin konkret plotësohen kushtet që për shkak të karakteristikave të lëndës që i njëjti të lirohet nga dënimi në përputhje me nenin 74 të KPRK-së. Po ashtu i propozon gjykatës, që duke pasur parasysh se i njëjti është familjar dhe në përmbushjen e nevojave të përditshme ka nevojë që të përdorë automjetin, e gjithashtu për faktin se deri më tani asnjëherë nuk ka pasur ndonjë rast të kësaj natyre të veprave penale apo tjera, të mos e aprovoj propozimin e prokurorisë për shqiptimin e dënimit plotësues për të akuzuarin.

I akuzuari Sh. R., në fjalën përfundimtare deklaron se, e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit të tij sipas detyrës zyrtare, e pranon fajësinë, i vije keqe për rastin që i ka ndodhur, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i premtun gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë vozitjes. Andaj kërkon nga gjykata që nëse eventualisht gjen prova dhe e shpall fajtor, mundësisht t'i shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit. Po ashtu deklaron se me rastin e shkakimit të kësaj vepre penale ka pësuar shqetësime të mëdha dhe të njëjtën e ka përjetuar shumë rëndë, sepse si pasojë e kësaj vepre penale është lënduar rëndë bashkëshortja e tij, për të cilën ai personalisht është dashur që të kujdeset gjatë shërimit të saj, po ashtu e ndien vetën keqë dhe të shqetësuar edhe për dajën e tij Sh. S. i cili ka qenë me ta me rastin e aksidentit të komunikacionit, por i njëjti për fat të mirë ka pësuar vetëm lëndimet të lehta trupore.

Gjykata, nga të cekura si më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së vepër penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor pasi u vërtetuar përgjegjësia penale juridike e tij, por duke i vlerësuar të gjitha rrethanat dhe duke u mbështetur në nenin 74, paragrafi 1, pika 1.1 të KPRK-së ka konstatuar se ekzistojnë bazat e posaçme të lirimit nga dënimi për veprën penale të kryer nga pakujdesia, pasi që pasojat e veprës penale aq rëndë e kanë goditur kryerësin e veprës penale sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij. Se me të vërtetë vepra penale e ka goditur aq shumë të akuzuarin, gjykata e vërtetoi edhe nga fakti se i akuzuari gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor ka qenë i shqetësuar dhe i prekur thellë për rastin që ka ndodhur, i akuzuari dhe e dëmtuara, bashkëshortja e tij Xh. jetojnë së bashku, i njëjti kujdeset për të, e sidomos tani kur e njëjta është në gjendje të rëndë për shkak të lëndime të pësuar në aksident.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh edhe për preventivën e përgjithshme dhe se vepra është kryer nga pakujdesia, prandaj ka ardhur në përfundim se dënimi paraqitet i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij nga neni 38 të KPRK-së.

Gjykata duke pasur parasysh se i akuzuari Sh. R. është kryefamiljar dhe në përmbushjen e nevojave të përditshme familjare ka nevojë që të përdorë automjetin, e sidomos kur tani e ka të lënduar bashkëshorten e tij, e gjithashtu për faktin se deri më tani i njëjti asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin, nuk e ka aprovuar propozimin e Prokurorisë që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit.

Të dëmtuarit Xh. R. dhe Sh. S., nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk parashetrojnë kërkesë pasurore juridike.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 449 paragrafi 1 i KPPRK-së, e obligon të akuzuarin që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 20 €, 20 € në emër të shpenzimeve të ekspertizës mjeko ligjore, si dhe nga 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimet, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2023:221648, 13.03.2024**

**G j y q t a r i**

---

Sadri Krasniqi,d.v.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë ) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.